


AA 12-1179  

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË



**BSA**

Bailiff Services Albania

Tiranë, më datë 12.11.2019

Nr. 2510 .Prot  
Nr.1285.Regj

**V E N D I M**

**Për Shitjen me Ankand të Parë të Pasurive të Paluajtshme**

Pranë shoqërisë përmbarimore "Bailiff Services Albania" sh.p.k, është depozituar kërkesa e palës kreditore "Credins Bank" sh.a. në date 09.12.2013 sëbashku me **Urdhërin e Ekzekutimit nr. 12-2012-2185 datë 12.09.2012** të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë të lëshuar për **Kontraten e Kredisë Afatgjate nr.28/date 18.09.2008, nr.2032 rep, nr.921 kol date 22.09.2008 me pale:**

- Kreditor: "Credins Bank" sh.a.
- Debitor : Skender Gjumsi
- Dorëzanës: P.F "Skender Gjumsi", Kimete Gjumsi
- Objekti : Kthim kredie

Në bazë të nenit 517 të K.Pr.Civile i është komunikuar palës debitore njoftimi për kryerjen e ekzekutimit në mënyrë vullnetare. Me marrjen dijani nga ana e palës debitore nuk është vepruar për shlyerjen e detyrimit. Për rrjedhojë në bazë të nenit 519 të K.Pr.Civile për të bërë të mundur ekzekutimin e titullit, ekzekutimi është kaluar në ekzekutim të detyrueshëm duke vendosur masën e sekuestros mbi pasurine e paluajtshme të palës debitore. Pasi është vendosur masa e sekuestros nga ana jonë i është dërguar njoftim palëve debitor dhe kreditor që brenda afatit ligjor prej 7 (shtatë) ditë të caktojne me mirëkuptim ndërmjet tyre çmimin e pasurisë së paluajtshme. Megjithëse afati ka kaluar pranë shoqërisë përmbarimore nuk është depozituar asnjë marrëveshje për caktimin e çmimit të pasurisë së paluajtshme. Për rrjedhojë për vlerësimin e pasurisë së sekuestruar në përputhje me nenin 564 të K.Pr.Civile është caktuar ekspert i licencuar i cili ka kryer vlerësimin e pasurisë së paluajtshme të palës debitore. Në bazë të aktit të ekspertimit të paraqitur nga eksperti si dhe mbështetur në nenin 564 të K.Pr.Civile është caktuar çmimi i pasurisë së paluajtshme. Ky çmim i'u është komunikuar palëve në proces ekzekutimi sëbashku me aktin e vlerësimit të pronës. Gjithashtu i është lënë afat palës debitore për të shlyer detyrimin por nga ana e saj nuk është vepruar, si dhe pranë shoqërisë përmbarimore nuk është depozituar asnjë vendim gjyqësor për pezullimin e veprimtarisë përmbarimore. Për rrjedhojë duhet të shpallet ankandi i parë për pasurinë e paluajtshme i cili fillon me vlerën 80 përqind të çmimit të përcaktuar sipas nenit 564 të K.Pr.Civile.

**Në bazë të nenit 567,568 të K.Pr.Civile.**

**V E N D O S A**

**1-Të shpall ankandin e I (parë) për shitjen e pasurisë së paluajtshme me 20% zbritje nga vlera e vlerësuar nga eksperti, për pasurinë:**

- -Pasuri nr.4/164-ND, vol 4, faqe 22, ZK 3234, lloji I pasurise ( ndertese) me sip 70 m<sup>2</sup>, me adrese Rrogozhine, ne pronesi te Skender Haziz Gjumsi, me vlere 5,600,000 leke

**Çmimi i pasurisë në ankand të parë është në masën 5,600,000 Leke**

2-Secili ofertues duhet të depozitoje si garanci në llogarinë e Shoqërisë Përmbartimore “Bailiff Services Albania” sh.p.k. me nr. NIPT L02127004B shumën prej 10% të çmimit fillestar, në numrin e llogarisë pranë Credins Bank sh.a.

**IBAN AL 4621 2110 1600 0000 0000 253 135 nr. llog. 00000 25 31 35 (leke)**

3-Ankandi do të qëndrojë i publikuar nga data 12.11.2019 deri në datë 26.11.2019 dhe zhvillohet në këtë datë ora 16:00 pranë zyrave të Shoqërisë Përmbartimore “Bailiff Services Albania” sh.p.k

4-Publikimi i këtij ankandi kryhet konform nenit 568 të K.Pr.Civile.

5-Ky vendim i komunikohet palëve, të cilët kundër tij kanë të drejten e ankimit brenda 5 diteve në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor.

**Shoqëria Përmbartimore “Bailiff Services Albania” sh.p.k  
Përmbartues Gjyqësor Privat  
ERION LLALLA**

